



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.204/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Skënder Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Iniciativa “URA”, të paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Zgjedhjeve Lokale të mbajtura në 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 15.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e subjektit politik, Iniciativa “URA”, e evidentuar ZL.Anr.204/2025, e datës 13.10.2025, paraqitur kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK) për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Zgjedhjeve Lokale të mbajtura në 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 13.10.2025, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Danush Ademi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Ferizajt nga Iniciativa “URA”, pretendon se më datë 12.10.2025, rreth orës 16:00, në rrugën Naim Beka të fshatit Dubravë të komunës së Ferizajt afër Shtabit të tij Zgjedhor, ndërsa po hynte në veturën e tij për t'u nisur drejt shtëpisë së tij të merrte familjen e tij për të votuar, është sulmuar fizikisht duke e nxjerr më dhunë nga vetura nga disa anëtarë dhe aktivistë të këtij subjekti politik. Sipas ankuesit, ky sulm është organizuar dhe motivuar politikisht nga kryetari i PDAK-së, Qazim Rrahmani me qëllim që të dëmtohet imazhi i tij publik si dhe kjo të ndikoj në rezultatin e tij zgjedhor dhe në prishjen e qetësisë publike gjatë ditës së zgjedhjeve. Ai shton se si pasojë e këtij sulmi ka pësuar lëndime trupore nga rrëzimi dhe goditjet, dhe se janë sulmuar edhe dhjetëra anëtarë të partisë së tij. Ankuesi thekson se rasti është raportuar në Polici dhe aktualisht po trajtohet nga organet e sigurisë dhe drejtësisë si sulm i rëndë fizik. Në përfundim, ankuesi kërkon nga PZAP-i që të ndërmerren masa ligjore ndaj kryesit të veprës, duke u bazuar

sipas Ligjit për Zgjidhjet e Përgjithshme dhe Kodit të mirësjelljes. Si provë, parashtuesi i ankesës ka bashkangjitur videon në CD që është inçizuar nga kamerat e lokalit të tij .

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Partia demokratike e Ashkanlive të Kosovës kanë theksuar se i kundërshtojnë në tërësi pretendimet e thëna në ankesë. PDAK pretendon se ngjarja e ndodhur në fshatin Dubravë të komunës së Ferizajt nuk ka ndodhur pranë Shtabit Zgjedhor të subjektit politik Iniciativa “URA” e nuk është as zyrë e këtij subjekti siç pretendon parashtuesi i ankesës por pranë një lokali në pronësi të djalit ose të ndonjë familjari të Danush Ademit në të cilin lokal deri më datën 12.10.2025 ka pasur vetëm postera të Iniciativës në fjalë , kjo e rrëzon faktin e pretenduar nga Iniciativa “URA” që kinse janë sulmuar zyrat e shtabet e Iniciativës se tyre sepse këto zyrë kanë objekt dhe lokacion tjetër . Tutje në përgjigje , PDAK sqaron se ky konflikt nuk ka të bëjë fare mes PDAK-së dhe Iniciativës “URA” dhe as me procesin zgjedhor por edhe sipas policisë është konflikt familjarë në mes qytetarëve e jo politik apo për çështje politike . PDAK deklaron se Qazim Rrahmani ka qenë prezent më familjarët e tij duke kaluar në rrugën Naim Beka dhe Danush Ademi ka fyer e ofenduar familjarët e kryetarit Rrahmani dhe pas kësaj ngjarje ka ndodhur konflikti verbal e fizik në mes tyre edhe sipas policisë por Qazim Rrahmani nuk ka qenë pjesë e rrahjes dhe nuk ka përdorur as forcë e as gjuhë ofenduese ndaj Danush Ademit por më gjithë energjinë e tij ka tentuar të largoj familjarët e tij nga vendngjarja dhe sipas tyre ka me qindra qytetarë që kanë qenë deshmitarë të rastit në fjalë dhe që mund të deklarohen . PDAK ka pranuar video nga qytetarët dëshmitar në rast dhe të njëjtat i ka dorëzuar në PZAP dhe njëherit theksojnë se Qazim Rrahmani është i lirë dhe jo i ndjekur penalisht apo i akuzuar nga Policia për këtë rast por kjo është vetëm shpifje nga Danush Ademi dhe se ankesa është bërë pas rezultateve preliminare të publikuar në KQZ ku PDAK prin krahas Iniciativas “URA” Danush Ademi e përdor për arsyetim politik dhe problemet e tij i paraqet si politike . PDAK dhe Qazim Rrahmani nuk mbajnë asnjë përgjegjësi personale juridike për veprimet e qytetarëve të thjeshtë ose problem mes familjarëve dhe ky rast nuk është për t’u trajtuar në PZAP por në Polici , Gjykatë apo Prokurori .

Si prova në përgjigje në ankesë, PDAK ka bashkangjitur video ku Danush Ademi ka filluar me sharje dhe ofendime në drejtim të familjes Rrahmani , deklaratën e kryetarit Qazim Rrahmani lidhur më rastin dhe si ka ndodhur rasti ,PDAK shpreh keqardhje dhe nuk pajtohet më këto veprime të ndodhura nga palët në konflikt .Andaj ,PDAK kërkon nga PZAP që ankesa e parashtuar të hidhet si e pabazuar ose si e pa lejuar për trajtimin e rastit në fjalë .

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

- **Ankesa është e pabazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik , vlerësoj se pretendimet e subjektit politik ,Iniciativa “URA”, janë të pa qëndrueshme dhe

si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 35 paragrafi 1 të LZP-së, Nr.08/L-228 me të cilën përcaktohet: *"Përdorimi ose kërcënimet me përdorim të dhunës se çfarëdo lloji nga subjekti politik, anëtarët, mbështetësit ose kandidatët e tyre, ndalohet rreptësisht"* po ashtu edhe paragrafi 2 i këtij neni ku parashihet se *"Asnjë subjekt politik ose kandidatët nuk inkurajojnë, mbështesin ose miratojnë dhunën, kërcënimet me dhunë dhe kanosje gjatë procesit zgjedhor"*, kjo pasi nuk ka mundur të vërtetohet se ky incident ka ndodhur në rrugë në afërsi të një kafiterie, që do të thotë se rasti ka ndodhur jashtë qendrës së votimit dhe nuk të bëjë me procesin zgjedhor, edhe pse në rastin konkret ka elemente të prishjes së rendit dhe qetësisë publike apo edhe veprës penale për të cilat duhet të merren organet përkatëse (të cilat edhe kanë filluar procedurën në këtë rast), sipas vlerësimit të panelit nuk ka shkelje të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të cilat hyjnë në kompetencë të PZAP-së.

Andaj, për tu konsideruar përgjegjës subjekti politik PDAK duhet të vërtetohej se përdorimi dhunës te jetë shkaktuar nga përkrahësit apo mbështetësit e subjektit politik në fjalë PDAK dhe i njëjti të ketë të bëjë me procesin zgjedhor, e të cilat fakte nuk kanë mundur të vërtetohen në rastin konkret. Duke marrë parasysh këto fakte për Panelin nuk janë të provuara këto pretendime të theksuara në ankesë, sepse këto pretendime nuk janë të mbështetura në fakte dhe prova konkrete.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, andaj vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që nga provat e ofruara të cilat parashtuesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa
ZL.Anr.204/2025 datë 15.10.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.